



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:176942  
Datë: 31.08.2023  
Numri i dokumentit: 04634678

**PN.1.S.nr.165/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - DEPARTAMENTI SPECIAL**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi - kryetare e kolegjit, Kreshnik Radoniqi e Ferit Osmani, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve I.L. dhe H.G.për shkak të dyshimit të bazuar për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KPRK, dhe të pandehurin R.M., për veprën penale, Dhënia e ndihmës në kryerje të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, lidhur me nenin 33 të KPRK, duke vendosur në lidhje me ankesat e mbrojtësve të pandehurve I.L., av. Durim Osmani dhe av.Feim Alaj, H. G., av. Bekim Kelani dhe R.M., av.Mahmut Halimi, të paraqitura kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PPPS.nr.35/2023, i datës 19.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 31.08.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të pandehurve I.L., av. Durim Osmani dhe av.Feim Alaj, H. G., av. Bekim Kelani dhe R.M., av.Mahmut Halimi, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PPPS.nr.35/2023 i datës 19.08.2023, ashtu që të pandehurve **I.L., H.G .dhe R.M.**, ju ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit lirohen menjëherë për t'u mbrojtur në liri, sot me datë 31.08.2023.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktvendimin, PPPS.nr.35/2023, të datës 19.08.2023, ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muajsh, të pandehurve I.L., H.G.dhe R.M., për shkak të veprave penale te cekura si në hyrje të këtij aktvendimi. Caktimi i masës se paraburgimit është bërë konform nenit 184 par.1 nënpar.1.1 e 1.2, në lidhje me pikat 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

më tutje (KPPRK), ashtu që sipas këtij aktvendimi masa e paraburgimit të pandehurve u është caktuar nga data 18.08 2023 dhe do t'iu zgjasë deri më datë 18.09.2023.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor kanë paraqitur ankesë:

- Mbrojtësit e të pandehurit I.L., av. Durim Osmani dhe av. Feim Alaj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, t'a prish aktvendimin e ankimuar dhe çështjen t'a kthejë në rivendosje ose t'a ndryshoj duke caktuar një masë me të lehtë.
- Mbrojtësi i të pandehurit H. G., av. Bekim Kelani, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, t'a aprovoj si të bazuar ankesën dhe aktvendimin e ankimuar t'a ndryshoj duke liruar të pandehurin.
- Mbrojtësi i të pandehurit R.M., av. Mahmut Halimi, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje së ligjit materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, t'a ndryshoj aktvendimin e ankimuar ashtu që ndaj të pandehurit të hiqet masa e paraburgimit për ti mundësuar mbrojtja në liri ose të zëvendësohet me ndonjë masë me të butë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me shkresën, PAR/L.nr.1070/23, të dt.28.08.2026, ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të pandehurve, të refuzohet si e pabazuara, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit - Departamenti Special, në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa dhe gjeti se: **Ankesat janë të bazuara.**

Mbrojtësit e të pandehurit I.L. – av. Durim Osmani dhe av. Feim Alaj në ankesë pretendojnë se nuk vërtetohet dyshimi i bazuar që është kryer vepra penale ashtu siç është përcaktuar në nenin 19 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se dyshimi i bazuar ekziston kur vëzhguesin objektiv e bindin në bazë të provave të artikuluar dhe të pranueshme se i dyshuari e ka kryer veprën penale. Mbrojtja në ankesë thekson që ka pasur kushte ligjore për përjashtimin e Ligjit për Prokurimit Publik në kuptim të dispozitës së nenit 3 par. 1 të këtij ligji dhe po ashtu këto kushte janë subsimuar duke marrë parasysh katër zhvillimet që kanë ndodhur në muajin shkurt të vitit 2022 si fillimi i luftës në Ukrainë, embargo më produkte ushqimore bazë nga të gjitha vendet rajonale dhe botërore, mungesa e rezervave shtetërore, rritja enorme e çmimit të vajit, sheqerit dhe grurit në tregun e Kosovës, të gjitha këto zhvillime që vërtetojnë se rezervat shtetërore janë me interes së sigurisë së Kosovës, ashtu siç përcaktohet në dokumentin zyrtar të vitit 2022 të Qeverisë së Kosovës. Mbrojtja në ankesë thekson se pretendimi i Prokurorisë se përjashtimi i Ligjit për Prokurimin Publik ka qenë i kundërligjshëm, ngase për të gjitha procedurat e prokurimit në parim aplikohet Ligji për Prokurimit Publik mirëpo përjashtimet janë të përcaktuara në nenin 3 në mënyrë të përgjithshme dhe taksative, në rastin konkret përjashtimet janë bërë për shkak të interesit të sigurisë kombëtare. Shton se i mbrojturi i tyre dyshohet për ndikim në komisionin për negociim të kontratave për blerje të grurit, sheqerit dhe vajit, me asnjë provë material ky ndikim nuk vërtetohet, po ashtu nëse analizohet dosja e çështjes penale rezulton se përzgjedhja e operatorit ekonomik turk dhe polak është bërë nga komisioni dhe jo nga I.L., për më tepër me rastin e nënshkrimit të kontratave lëndore janë caktuar menaxherët e kontratave të cilët kanë pasur përgjegjësi për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës

dhe kjo përgjegjësi nuk i takon të mbrojturit të tyre. Mbrojtja me tutje shton që edhe nëse supozojmë që njëra fazë e përmbushjes së kontratave publike ka pasur mangësi, kjo nuk nënkupton që është kryer vepra penale nga neni 414 i KPRK-së, pasi që kjo vepër kryhet me dashje direkte dhe me qëllim të përfitimit, andaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të vendosë si në propozimin e lartcekur.

Mbrojtësi i akuzuarit H.G.– av. Bekim Kelani në ankesë thekson se çështja e rezervës shtetërore sipas strategjisë për siguri kombëtare e vitit 2022-2027 të Qeverisë së Kosovës konsiderohet si çështje me rëndësi për sigurinë e vendit, prioritet i zhvillimit të politikave për krijimin e rezervave shtetërore me qëllim të zbutjes së pasojave dhe krizës shtetërore, në kuptim të këtij dokumenti zyrtar, fjala interes i sigurisë aplikohet dhe përfshinë edhe rezervat shtetërore në kuptim të nenit 3 par. 1 të Ligjit të Prokurorit Publik. Sa i përket pagesës së avancit është bërë në kundërshtim me ligjin ky pretendim sipas mbrojtjes nuk qëndron, ngase në rrethana specifike sipas Ligjit për Ndarje Buxhetore dhe në Buxhetin e Republikës së Kosovës të vitit 2022 neni 13 par. 5, lejohen avancet deri në 100 % në shumën e plotë nga ndarja buxhetore e vitit aktual për projekte që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë shtetërore, çështja e rezervave shtetërore një javë pas fillimit të luftës në Ukrainë dhe embargoeve të ndërsjellta të shteteve rajonale për produktet bujqësore, rezervat shtetërore në kushtet e mungesës së tyre sipas vendimit të lartcekur të qeverisë është çështje e interesit publik. Sipas pretendimeve të mbrojtësit, gjykata nuk ka dhënë ndonjë arsyetim bindës që i akuzuari H.G.nëse gjendet në liri do të pengojë rrjedhën e procedurës penale, pasi që është zyrtar i lartë i MINT dhe mban pozita menaxheriale duke ndikuar në prova dhe në dëshmitarë, e njëjta nuk qëndron për faktin se sa i përket rrezikut të ndikimit me të vetmen arsye se i mbrojturi i tij më datë 31.07 dhe 01.08.2023, është intervistuar nga njësia e hetimeve të Policisë së Kosovës dhe pas kësaj i njëjti ka shkuar në punë si zakonisht dhe ka punuar për dy javë deri në ditën e arrestimit, po të kishte pasur atë qëllim që të ndikoj në prova apo dëshmitar shumë lehtë kishte për të e bërë dhe në objektivin e një analize të drejtë dhe në harmoni me dispozitat ligjore qoftë vendore apo edhe me aktet juridike ndërkombëtare, këtë pretendim të Prokurorisë të cilin e ka aprovuar gjykata e konsideron një supozim të pabazë dhe jo të mbështetur në prova. Mbrojtësi shton që karakteristikat dhe sjellja e H.G.flet se ai nuk ka kryer vepra penale dhe është hera e parë që ballafaqohet me organet e drejtësisë të Republikës së Kosovës, se ai mund të përsërisë apo të kryejë vepra tjera penale, andaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të vendosë si në propozimin e lartcekur.

Mbrojtësi i të pandehurit R.M.– av. Mahmut Halimi në ankesë pretendon që i mbrojturi i tij, ashtu siç ka deklaruar as nuk ka propozuar dhe as nuk ka negociuar kurrfarë kushtet për çfarëdo kontrate, ai ka pranuar dhe nuk e mohon në asnjë mënyrë se me vullnetin e tij të lirë ka hyrë në bashkëpunim me qëllim të gjetjes së tregut për blerjen e mallit – grurit, për nevoja të MINT-it dhe në rrethana të tilla duke konsideruar vetën obligativ që të shërbejë në të mirë të interesit shtetëror ka pranuar angazhimin pa kurrfarë kompensimi. Pretendimet e dhëna që i akuzuari R.M.kishte luajtur rolin e ndërmjetësuesit ndërmjet MINT-it dhe operatorëve ekonomik nga të cilët do të siguroheshin këto produkte të rezervave shtetërore janë të pa sakta dhe pa asnjë mbështetje të vetme ngase i pandehuri Ridvan nuk ka pasur rolin e ndërmjetësimit, përkundrazi siç është theksuar edhe më sipër detyra e tij të cilën e ka pranuar ka qenë të gjejë operatorin dhe ti vejë në kontakt autoritetet e MINT-it të cilët kanë zhvilluar negociatat dhe kanë arritur marrëveshjen e çmimit të blerjes dhe kushtet e tjera të rregulluara me kontratë në mes të operatorëve furnizues dhe MINT-it. Sipas mbrojtësit, është e pakontestueshme që i pandehuri R. nuk ka pasur autorizim formal, por ekzistimi i autorizimit të tillë do të tërhiqte pas vetes edhe përpilimin e një kontrate të përfaqësimit në mes të tij dhe MINT-it nga e cila ai do të realizonte fitimin deri në 2 % të blerjes së mallit të kontraktuar dhe kështu ai do të mirrte të gjitha

përgjegjësitë mbi vete dhe me siguri se nuk do të vinte deri tek kjo pozitë në të cilën ndodhet tani. Po ashtu, mbrojtësi shton që i mbrojturi i tij nuk ka marrë pjesë në negociim, nuk ka marrë pjesë në përcaktimin e çmimit dhe nuk ka pasur qasje minimale në kontaktet në mes të operatorit furnizues dhe MINT-it dhe roli i vetëm që ka pasur është gjetja e operatorit për furnizim me grurë, vaj dhe sheqer. Po ashtu, sa i përket bazës ligjore për caktimin e masës së paraburgimit që ka të bëjë me peshën e veprës penale, i njëjti nuk përmbush kërkesat e parashtruara të pikës 1, 2 dhe 3 të dispozitës së përmendur, ngase rregullat e procedurës të cilat janë zbatuar deri në arritjen e lidhjes së kontratave, për të pandehurin R. janë të panjohura, ndërsa në anën tjetër mundësia për përsëritjen e veprave penale është absurde duke pasur parasysh faktin se dy të pandehurit e parë janë suspenduar nga vendet e punës ndërsa i pandehuri R. ka rënë viktimë e gatishmërisë së tij për të kontribuar në gjetjen e operatorit furnizues pa kurrfarë fitimi përkundër me shpenzime vetanake dhe konsiderojnë që masa e rëndë e paraburgimit është e pavend dhe në kundërshtim me të gjitha normat të cilat ofrojnë siguri juridike për barazinë e çdo qytetari të Republikës së Kosovës para ligjit, andaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të vendosë si në propozimin e lartcekur

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e mësipërme ankimore janë të bazuara, ngase në aktvendimin e ankimuar gjykata e shkallë së para nuk ka arritur që të vërtetoj dyshimin e bazuar së të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat dyshohen, e për të cilat është kusht primar për ligjshmërinë e paraburgimit, mirëpo në arsyetim e aktvendimit të ankimuar janë dhënë me tepër bindje e dyshimit të arsyeshme duke mos pasur mbështetje në artukulushmerin për të ndërlidhur provat me veprimet e të pandehurve, prandaj nuk është arritur që të argumentohet në fuqinë provuese të provave se me veprimet e të pandehurve është arritur që të ketë dyshim për veprat penale dhe me këtë gjykata vetëm ka potencuar kronologjinë e ngjarjes mirëpo nuk ka dhënë vlerësim dhe arsyetim mbi fakte të cilat janë paraqitur në kërkesën për caktimin e paraburgimit si dhe në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar.

Kolegji penale i kësaj gjykate, në vlerësimin për ekzistimin e dyshimit të bazuar, konstaton se në këtë stad të procedurës penale nga gjykata e shkallë së pare është tejkaluar kompetenca e vlerësimit e parapara sipas normave ligjore nga fakti se gjykata në aktvendimin e ankimuar është lëshuar në vlefshmërinë e ligjshmërisë së ligjeve (administrative) si dhe vendimeve të qeverisë, si dhe në nxjerrjen e konkluzioneve të elementeve subjektive të dashjes në lidhje me veprat penale të cilat pretendohet të jene kryer nga ana e të pandehurve.

Kolegji nga shikimi i shkresave të lëndës, konkretisht të provave të paraqitura në kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka akceptuar tërësinë e kërkesës duke mos vlerësuar arsyeshmërinë e provave në drejtim të ekzistimit të dyshimit të bazuar, prandaj masa e përcaktuar e paraburgimit nuk ka arritur nivelin e konsumimit të kushteve të paraburgimit që të pandehurit t'i nënshtrohen kufizimit të drejtës së lëvizjes, prandaj jo çdo kërkesë për caktimin e paraburgimit duhet t'i jepet epiteti i aprovimit, mirëpo kjo duhet t'i nënshtrohet vlerësushmërisë sipas parimit të ligjshmërisë nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake në përputhje me provat si dhe më vlerësimin e pretendimeve të paraqitura nga ana e të pandehurve respektivisht të mbrojtësve.

Nga vlerësimi i aktvendimit të ankimuar, kolegji i kësaj gjykate, erdhi në përfundim se nuk është arritur që të krijohet bindja objektive në vlerësimin e secilës provë-fakt të paraqitur, në mënyrë që të krijohet kuptimësia e plotë se dyshimi i bazuar me të vërtete paraqet lidhje të sinkronizuar mes fakteve dhe veprimeve, e nga e cila edhe masa e përcaktuar e paraburgimit do të arrinte stadin e kufizimit të lirisë, duke mos shkelur nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe duke zbutur nenin 29 të Kushtetutës së Kosovës.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nga mos ekzistimi i dyshimit të bazuar të përcaktuar sipas nenit 19 pika 1.9 të KPPK-së, si dhe normës themeltare për të ekzistuar caktimi i paraburgimit nga nenin 184 par. 1 nën par. 1.1 nuk mund të qëndrojnë as kushtet /bazat e veçanta të masës së paraburgimit nga nenin 184 par.1 nën par. 1.2 pikat 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 416 par.2 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL  
PN.1.S.nr.165/23, datë 31.08.2023**

**Bashkëpunëtor Profesional**

**Bajram Rexhahmetaj**

**Kryetare e kolegjit,**

**Afërdita Bytyçi**